

Vendim i Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë SEGMENT SHA

Sot, ditën e hënë, datë 1 Nëntor 2021, në selinë e shoqërisë në Autostrada Tiranë – Durrës, kilometri 7, Kashar, Nr. 1051, Tiranë, u mbajt mbledhja e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë SEGMENT SHA, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar në datën 4.7.2012 dhe e regjistruar me numër unik L21916035A. Mbledhja u thirr nga administratorja e shoqërisë zonja Ajten Goci, për të diskutuar këtë rend dite:

Çështjet e rendit të ditës:

1. Zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Pjesëmarrës në mbledhje janë:

Zoti Ermir Goci, zotërues i 30 përqind të aksioneve dhe zonja Ajten Goci zotëruese e 60 përqind të aksioneve.


Mbledhja u drejtua nga administratorja e shoqërisë, znj. Ajten Goci, e cili mbajti edhe procesverbalin e mbledhjes.

Meqenëse mbledhja është njoftuar në datën 27.9.2021 dhe kuorumi i nevojshëm plotësohet, zonja Ajten Goci e deklaroi mbledhjen të mbajtur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës të përmendur më sipër.

Në shqyrtim të rendit të ditës Asambleja e Aksionarëve vëren:

Shoqëria aktualisht ka një kapital ligjor prej 10,000,000 Lek, i përbërë nga 100 aksione me vlerë nominale prej 100,000 Lekë secili.

Objekt i këtij operacioni do të jetë emetimi i 430 copë aksione të reja të pagueshme në para. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në regjistrin tregtar dhe në ditën e nesërme të publikimit shoqëria do të procedojë me emetimin e aksioneve dhe vënien e tyre në dispozicion për shitje. Aksionarët aktualë kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve të reja që do të emetohen, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar, që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet jo më vonë se 20 ditë pas publikimit në regjistrin tregtar. Pas kësaj date, aksionet janë të



SEGMENT SHA

Asambleja e Aksionarëve

shitshme lirisht tek palët e treta. Menjëherë pas shitjes së të gjitha aksioneve, administratorja është e detyruar të njoftojë regjistrin tregtar dhe regjistrin e aksionarëve për strukturën e re.

Në këtë mënyrë, kapitali ligjor i shoqërisë do të zmadhohet nga vlera 10,000,000 Lekë në vlerën 53,000,000 Lekë, i përbërë nga 530 aksione me vlerë nominale prej 100,000 Lekë secili.


Pasi shqyrtoi të gjitha çështjet Asambleja e Aksionarëve, vendosi:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit ligjor nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja të pagueshme në para.
2. Shoqëria do të emetojë 430 copë aksione të reja me vlerë nominale prej 100,000 Lekë secili.
3. Pas zmadhimit kapitali ligjor i shoqërisë do të bëhet 53,000,000 lekë, i përbërë nga 530 aksione me vlerë nominale prej 100,000 Lekë secili.

Meqenëse nuk ka më çështje për tu diskutuar, mbledhja mbyllet.

Ky vendim u mbajt në dy kopje identike dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.


Zonja Ajten Goci
Aksionare,


Zoti Ermir Goci
Aksionar

